



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 218, datë 31.10.2022

PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SI VLERËSUES TË DËMEVE NË SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, dhe Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Rinovimin e Licencës së z. Xhevair Basha, si vlerësues i dëmeve materiale motorike, në grupin e sigurimit të jo-jetës:**
 - **sigurime motorike.**
- 2. Licenca shoqërohet me deklaratën personale të nënshkruar nga vlerësuesi, sipas formatit bashkëlidhur.**
- 3. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE

DEKLARATË PERSONALE

Unë i nënshkruari, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se në zbatim të nenit 227, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, dhe Ligjit nr.10 076 datë, 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm së sektorin e transportit” të ndryshuar, do të ushtroj veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në mënyrë të pavarur, në përputhje me standartet profesionale dhe do të zbatoj kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurimeve dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Jam i ndërgjegjshëm dhe pranoj se mos plotësimi i kërkesave të mësipërme mund të jetë subjekt i masave të marra nga Bordi i AMF deri në tërheqjen e licencës.